

POLICI PËR POLICINË E KRIMEVE EKONOMIKE



#bashkeendreqim #UnitedAgainstCorruption #KS

Koalicioni i OJQ-ve "Java Kundër Korrupsionit 2017" përbëhet nga:
IKD, GLPS, ÇOHU, GAP, INPO, KIPRED dhe COLUMBUS

Autor: Instituti Columbus

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.



Ky projekt është mbështetur përmes grantit nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara, Prishtinë. Mendimet, të gjeturat dhe konkluzionet apo rekomandimet e shprehura janë të autorit dhe domosdoshmërisht nuk reflektojnë ato të Departamentit të Shtetit.

Rreth Institutit Columbus

Instituti është themeluar si organizatë e pavarur, joqeveritare, joprofitabile me vullnet të mirë dhe ka si qëllim promovimin e filozofisë politike dhe shoqërore të lirisë, demokracisë dhe barazisë në Kosovë.

Adresa: Nena Terezë 31b; Tel: +381 (0) 38 243 875 ; +377 (0) 44 555 404;

E-mail: info@instituticolumbus-ks.com

Dhjetor 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

| | |
|---------------------------------|---|
| I. Përmbledhje ekzekutive | 3 |
| II. Përshkrim i rastit | 4 |
| III. Gjetjet konkrete | 5 |
| IV. Pyetjet publike..... | 5 |

I. Përmbledhje ekzekutive

Korrupsioni është duke e sfiduar Policinë e Kosovës. Viteve të fundit, është venë në pikëpyetje roli dhe funksioni i kontrollit të brendshëm të këtij institucioni për luftimin e korrupsionit. Dyshimet për korrupsion të policëve të trafikut deri të akuzat për përfshirje të zyrtarëve të lartë të policisë në mbylljen e qëllimshme të hetimeve, duke marrë si kompensim shumë të majme të parave, janë disa nga rastet e bëra publike vitin e fundit.

Në mesin e këtij viti, një hulumtim i gazetës “Koha Ditore”, i ndjekur më pas edhe nga televizioni nacional “Kohavision”, kanë publikuar elemente, përmes të cilave janë ngritur dyshime se drejtori i suspenduar i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës është i përfshirë në mbylljen e një rasti në shkëmbim të parave.

Nga raportet e medieve, të cilat e kanë ndjekur këtë rast, hetimi që në start është rrezikuar nga vetë Policia e Kosovës. Hetimi fillimisht kishte nisur për një OJQ të quajtur QAD, për të cilën deri në atë kohë pak kush kishte dëgjuar. Policia e Kosovës kishte arrestuar në fillim të janarit të vitit 2017 nëntë persona në një operacion të gjerë policor, bashkë me Doganën dhe Administratën Tatimore, kundër të dyshuarve për organizim të skemave piramidale, bixhozit dhe krim të organizuar. Por arrestimi i tyre kishte ardhur pas një rezistence ndaj zyrtarëve ose sekserëve të vetë deklaruar të Policisë së Kosovës që të paguanin rreth 100 mijë euro.

Sipas provave të publikuara deri me tash, është e padiskutueshme lidhja e drejtorit të suspenduar të Krimeve Ekonomike, Emin Beqiri, me sekserin, i cili iu kërkonte para, Rrahim Hashimi.

Pas raportimeve mediale, Prokuroria e Shtetit kishte deklaruar se ka nisur ta hetojë Beqirin.

Askush nga Policia e Kosovës, duke përfshirë drejtorin, Shpend Maxhuni, nuk janë deklaruar asnjëherë për këtë rast. Policia e Kosovës, edhe pse ende ruan “imazhin e mirë” në shoqëri, ka pësuar rënie të madhe këtë vit.

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK), me javë të tëra, kishte rezistuar të ndërmarrë çfarëdo mase për drejtorin e Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri, i cili, sipas provave të siguruara dhe publikuara nga “Koha Ditore”, është i përfshirë në një rast të mbylljes së hetimit me para.

Pas më shumë se dy muajsh dhe pasi që zyrtarisht ishin njoftuar nga Prokuroria Speciale se Beqiri tashmë po hetohet për vepra që lidhën me korrupsionin, IPK-ja kishte vendosur që të transferojë Beqirin nga pozita e drejtorit të Krimeve Ekonomike në një pozitë në administratën e këtij institucioni.

II. Përshkrim i rastit

Drejtori i Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri, i kishte siguruar drejtuesit e Qendrës për Avokim dhe Diplomaci (QAD) që, së bashku me sekserin Rrahim Hashimi, do t'ua mbyllte rastin. Përveç se ishte në dijeni se sekseri në emër të Policisë se Kosovës po u kërkonte para personave në fazën preliminare të mbledhjes së informatave, ai i kishte porositur edhe të veprojnë siç u thoshte Rrahim Hashimi, i cili sapo kishte nisur mbledhja e informatave, u kishte kërkuar para.

Prokuroria kishte nisur vitin e kaluar një hetim për disa zyrtarë të Qendrës për Avokim dhe Diplomaci (QAD) nën dyshimin se kanë krijuar skema piramidale, nëpërmjet të cilave kanë mashtruar fermerë të shumtë.

Por, siç raportuan mediet, kësaj OJQ-je në vazhdimësi i janë kërkuar para nga sekserë të Policisë se Kosovës për t'ia mbyllur rastin.

Sekseri Rrahim Hashimi, që thirrej në emër të tij e që i kishte kërkuar 100 mijë euro për të mbyllur këtë rast, është në burg. Beqirit, ani pse është futur nën hetime, Policia e Kosovës vetëm ia ka ndërruar pozitën deri në përfundim të hetimeve. Për me tepër, ky institucion ka tentuar të fshehtë provat që implikonin Beqirin në këtë rast. Në një telefon të tipit "Iphone 6" gjendeshin provat se si një sekser, në koordinim me Policinë e Kosovës, po kërkonte 100 mijë euro për mbylljen e një rasti hetimor për Qendrën për Avokim dhe Diplomaci (QAD).

Provat e inkriminonin shefin e Krimeve Ekonomike në Policinë e Kosovës, Emin Beqiri, si dhe sekserin e Policisë, Rrahim Hashimi. Por, pas konfiskimit nga Policia e Kosovës, nga ky telefon janë fshirë të gjitha dëshmitë në lidhje me bisedat për pagesën e ryshfetit për mbylljen e një rasti të hetimit.

Pasi paratë nuk ishin paguar, zyrtarët e Qendrës për Avokim dhe Diplomaci ishin arrestuar, ndërsa ishin konfiskuar edhe disa gjëra, në mesin e tyre edhe ky telefon. Konfiskimi i telefonit kishte ndodhur më 2 dhjetor. Në këtë telefon ata kishin të incizuara video dhe audio të sekserit të Policisë, Rrahim Hashimi, i cili po u kërkonte para dhe prova për përfshirjen e Emin Beqirit."

Por në lidhje me këto raste, Policia e Kosovës ka thënë se ka dëshmuar "ndëshkueshmëri të brendshme" pa sqaruar se kush është ndëshkuar.

III. Gjetjet konkrete

- Lidhja e Emin Beqirit me një i cili ka kërkuar para në emër të institucionit ku punon Beqiri;
- Nëse Beqiri nuk kishte marrë para nga OJQ-ja që po hetohej, si ishte e mundur që Rrahim Hashimi të dinte çdo lëvizje të Policisë së Kosovës. Si mund të dinte një person jashtë Policisë së Kosovës se kur behët bastisja. Fakti që nga sms që janë publikuar është dëshmuar se një person jashtë këtij institucioni kishte ndikim aq të madh sa që edhe të shtynte urdhër-arrestet e urdhër-bastisjet, flet për një zinxhir komunikimi mes Policisë së Kosovës dhe sekserit që kërkonte para për mbylljen e hetimeve.
- Pas bastisjes së QAD-it nga Policia e Kosovës janë sekuestruar prova të ndryshme. Në mesin e tyre edhe prova që inkriminonin Beqirin e Hashimin në këtë rast. Në një telefon të tipit “Iphone 6” gjendeshin provat se si Hashimi, në koordinim me Policinë e Kosovës, po kërkonte 100 mijë euro për mbylljen e një rasti hetimor për QAD-in. Incizimet ishin fshirë nga telefoni. Kjo ishte dëshmuar nga ekspertiza e forenzikës, e cila ishte kryer me kërkesë të Prokurorisë së Shtetit.
- Prokuroria e Shtetit, edhe pas rreth shtatë muajsh prej kur ka ndodhur ngjarja, nuk ka dhënë përgjigje se ku ka mbetur hetimi, nëse është zgjeruar dhe për çka është zgjeruar. Hetimi përkundër rëndësisë së madhe, është duke kaluar pa transparencë nga ana e Prokurorisë së Shtetit.

IV. Pyetjet publike

- Sa janë të sigurt provat që sigurohen nga Policia e Kosovës për vepra të ndryshme penale ku mund të jenë të përfshirë zyrtarët policorë?
- Si mund të fshihen këto prova përderisa llogaritën se janë të sigurt në “duart e policisë”?
- Pse Prokuroria e Shtetit dhe IPK-ja kanë rezistuar që të hetojnë shefin e Krimeve Ekonomike?
- Përfshirja e Emin Beqirit në këtë aferë a e vë në pikëpyetje kredibilitetin e hetimeve të kryera nga drejtoria që ka udhëhequr?
- Si të sigurohen hetime të pavarura në këtë rast?